LIGJ
Nr.9937, datë 26.6.2008

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5800, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTË
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Letonisë,

me dëshirën, që me qëllim zhvillimin dhe lehtësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të tyre ekonomike, për të përfunduar një Konventë për mënjanimin e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me taksat mbi të ardhurat dhe kapitalin,

kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1
Personat e përfshirë

Kjo Konventë zbatohet për personat që janë rezidentë në njërin ose në të dy Shtetet Kontraktuese.

Neni 2
Tatimet e përfshira

1. Kjo Konventë zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që vihet nga ana e

një Shteti Kontraktues ose autoriteteve vendore, pavarësisht nga mënyra e mbledhjes së tyre.

2. Tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin konsiderohen të gjitha tatimet që vihen mbi të ardhurat e plota, kapitalin e plotë ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë këtu tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pronës së luajtshme ose të paluajtshme, si edhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet Konventa janë veçanërisht:

a) në Shqipëri:

i) tatimi mbi të ardhurat (përfshirë tatimin mbi fitimin e personave juridikë dhe tatimin mbi të ardhurat personale);

ii) tatimi mbi veprimtaritë e biznesit të vogël;

iii) tatimi mbi pronën;

(këtu "tatim shqiptar");

b) në Letoni:

i) tatimi mbi të ardhurat e personave juridikë (uznemumu ienakuma nodoklis);

ii) tatimi mbi të ardhurat personale (iedzivotaju ienakuma nodoklis); dhe

iii) tatimi mbi pasuritë e paluajtshme (nekustama ipasuma nodoklis);

(këtu "tatim letones").

4. Konventa zbatohet gjithashtu edhe për çdo tatim identik apo shumë të ngjashëm që vihet pas datës së nënshkrimit të Konventës, përveç ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të rëndësishëm që është bërë në legjislacionin e tyre tatimor.

Neni 3
Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllime të kësaj Konvente, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) termat "Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose Letoninë;

b) termi "Shqipëri" do të thotë Republika e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, do të thotë territori i Republikës së Shqipërisë, përfshirë këtu ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë tjetër përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila, sipas legjislacionit të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda të cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

c) termi "Letoni" do të thotë Republika e Letonisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, do të thotë territori i Republikës së Letonisë dhe çdo zonë tjetër pranë ujërave territoriale të Republikës së Letonisë brenda të cilave në bazë të ligjeve të Letonisë dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, të drejtat e Letonisë mund të ushtrohen në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

d) termi "person" përfshin një individ, shoqëri ose çdo grup tjetër personash;

e) termi "shoqëri" do të thotë çdo person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) termat "ndërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

g) termi "shtetas" do të thotë:

i) çdo individ që ka shtetësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri apo shoqatë që ka statusin e saj si të tillë nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

h) termi "trafik ndërkombëtar" do të thotë çdo transport me anije ose avion që operohet nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues, përveçse kur anija ose avioni operon vetëm ndërmjet

vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues;

i) termi “autoriteti kompetent” do të thotë:

i) në Shqipëri: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

ii) në Letoni: Ministria e Financave ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj.

2. Në lidhje me zbatimin e Konventës në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përkufizuar këtu, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka në atë kohë sipas ligjit të atij shteti për qëllime tatimore për të cilat zbatohet Konventa, çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti që ka epërsi mbi kuptimin që merr termi sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

Neni 4

Rezidenti

1. Për qëllimet e Konventës, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” do të thotë çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, u nënshtrohet tatimeve për shkak të vendbanimit të përhershëm, vendbanimit të përkohshëm, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose ndonjë kriteri tjetër të kësaj natyre dhe përfshin gjithashtu atë shtet dhe autoritet vendor të tij. Ky term, megjithatë, nuk përfshin asnjë person që i nënshtrohet tatimeve në atë shtet vetëm në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë shtet ose kapitalin që ndodhet në të.

2. Kur për arsye të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku ka banesë të përhershme; nëse ka një banesë të përhershme në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit me të cilin marrëdhëniet e tij personale dhe ekonomike janë më të afërta (qendra e interesave jetësore);

b) nëse shteti ku ka qendrën e interesave të tij jetësore nuk mund të përcaktohet, ose nëse ai nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë prej shteteve, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku ka banesën e zakonshme;

c) nëse ka një banesë të zakonshme në të dy shtetet ose në asnjë prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku është shtetas;

d) nëse është shtetas i të dy shteteve, ose i asnjërit prej tyre, autoritetet përgjegjëse të Shteteve Kontraktuese zgjidhin çështjen me marrëveshje reciproke.

3. Kur për arsye të dispozitave të paragrafit 1 një person, i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese përpiqen ta zgjidhin çështjen me marrëveshje të përbashkët dhe përcaktojnë mënyrën e zbatimit të Konventës për këtë person. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, për qëllimet e Konventës, personi nuk e ka të drejtën e pretendimit të përfitimeve të parashikuara nga kjo Konventë.

Neni 5

Selia e përhershme

1. Për qëllim të kësaj Konvente, termi “seli e përhershme” do të thotë një vend i qëndrueshëm biznesi nëpërmjet të cilit drejtohet krejtësisht ose pjesërisht biznesi i një ndërmarrjeje.

2. Termi "seli e përhershme" përfshin në mënyrë të veçantë:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte; dhe

f) një minierë, një pus nafte ose gazi, gurore ose çdo vend tjetër për nxjerrjen e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” përfshin gjithashtu:

a) një kantier ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi apo veprimtari mbikëqyrëse në lidhje me to, por vetëm atje ku ky kantier, projekt apo veprimtari vazhdon më shumë se nëntë muaj;

b) ofrimin e shërbimeve, përfshirë këtu shërbime konsultimi, nga një ndërmarrje nëpërmjet të punësuarve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur veprimtaritë e kësaj natyre vazhdojnë brenda Shtetit Kontraktues për një periudhë ose periudha që së bashku arrijnë në tërësi më shumë se 6 muaj në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “filial i përhershëm” do të konsiderohet se nuk përfshin:

a) përdorimin e ambienteve vetëm për qëllim të ruajtjes, paraqitjes ose shpërndarjes së të mirave ose mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e të mirave ose mallrave që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të ruajtjes, paraqitjes ose shpërndarjes;

c) mbajtjen e të mirave ose mallrave që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim përpunimi nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për qëllim të blerjes së të mirave ose mallrave, ose për mbledhje informacioni për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për ndërmarrjen, të çdo veprimtarie tjetër të natyrës përgatitore ose mbështetëse;

f) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për kombinim të veprimtarive të përmendura në nënparagrafët “a” deri në “e” me kusht që veprimtaria në përgjithësi e një vendi të caktuar biznesi që rezulton nga ky kombinim të ketë natyrë përgatitore ose mbështetëse.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, ku një person - përveçse një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6 - vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka, dhe zakonisht e ushtron, në një Shtet Kontraktues, autoritetin për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, kjo ndërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në atë shtet në lidhje me çdo veprimtari që ai person kryen për ndërmarrjen, nëse veprimtaritë e këtij personi nuk kufizohen me ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të qëndrueshëm biznesi, nuk do ta bënin këtë vend të qëndrueshëm biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk konsiderohet se ka filial të përhershëm në një Shtet Kontraktues vetëm sepse kryen biznes në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me kompetencë të përgjithshme ose agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë sipas rrjedhës së zakonshme të biznesit të tyre.

7. Fakti që një shoqëri, rezidente në një Shtet Kontraktues, kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente në Shtetin tjetër Kontraktues, ose që ushtron biznes në shtetin tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose tjetër) nuk përbën në vetvete as shoqëri dhe asnjë seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6
Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat që një rezident i një Shteti Kontraktues përfton nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Termi “pronë e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku ndodhet pasuria në fjalë. Termi në çdo rast përfshin sendet aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet që përdoren në bujqësi dhe pyje, të drejta për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të përgjithshëm në lidhje me pasurinë tokësore, uzufruktin e pronës së paluajtshme dhe të drejta për pagesa të ndryshueshme ose të pandryshueshme si shpërblim për

funksionimin e, ose të drejtën për punë, depozita minerare, burime dhe burimeve të tjera natyrore. Anijet dhe avionët nuk konsiderohen pronë e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, lënia në përdorim apo përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme, si dhe nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme.

4. Nëse pronësia e aksioneve ose të drejtave të tjera të një shoqërie i japin të drejtë pronarit të këtyre aksioneve ose të drejtave për gëzimin e pasurisë së paluajtshme që zotërohet nga shoqëria, të ardhurat nga përdorimi i drejtpërdrejtë, lënia në përdorim ose përdorimi në një formë tjetër i këtyre të drejtave të gëzimit mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet pasuria e paluajtshme.

5. Dispozitat e paragrafëve 1, 3 dhe 4 zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7
Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje. Nëse ndërmarrja kryen biznes si më lart, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë që i atribuohet atij filiali të përhershëm.

2. Sipas dispozitave të paragrafit 3, nëse një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, këtij filiali të përhershëm në çdo Shtet Kontraktues do t'i atribuohen fitimet që mund të pritet të nxjerrë nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë e përfshirë në veprimtari të njëjta ose të ngjashme sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe nëse merrej tërësisht dhe në mënyrë të pavarur nga ndërmarrja, filial i së cilës është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një filiali të përhershëm në një Shtet Kontraktues, do të lejohen, si zbritje shpenzimet (përveç shpenzimeve që nuk do të ishin të zbritshme nëse ky filial i përhershëm do të ishte një ndërmarrje e veçantë e një Shteti Kontraktues) që janë bërë për qëllime të filialit të përhershëm, përfshirë këtu shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative që janë bërë qoftë në shtetin ku ndodhet filiali i përhershëm, qoftë diku tjetër.

4. Për aq sa është e zakonshme në një Shtet Kontraktues të përcaktojë fitimet që i atribuohen një filiali të përhershëm në bazë të pjesës së fitimeve totale të ndërmarrjes me pjesët e saj të ndryshme, asnjë dispozitë në paragrafin 2 nuk do të pengojë Shtetin Kontraktues për të përcaktuar fitimet që do të tatohen nga një ndarje e tillë siç mund të jetë e zakonshme; metoda e miratuar e ndarjes, megjithatë, do të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë përfitim nuk do t'i atribuohet një filiali të përhershëm për shkak të blerjes nga ky filial i përhershëm i të mirave dhe mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, përfitimet që do t'i atribuohen filialit të përhershëm do të përcaktohen me të njëjtën mënyrë vit pas viti, nëse nuk ka arsye të plotë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zëra të të ardhurave që trajtohen në mënyrë të veçantë në nene të tjera të kësaj Konvente, atëherë dispozitat e këtyre neneve nuk do të preken nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8
Transporti ndërkombëtar

1. Fitimet e një ndërmarrjeje në një Shtet Kontraktues nga operimi i anijeve ose i

avionëve në trafikun ndërkombëtar tatohen vetëm në atë shtet.

2. Për qëllimet e këtij neni, fitimet nga operimi i anijeve ose i avionëve në trafikun ndërkombëtar përfshijnë:

a) fitimet nga dhënia me qira e anijeve ose avionëve pa ekuipazh; ose

b) fitimet nga përdorimi, mbajtja ose dhënia me qira e kontenierëve (duke përfshirë trailerat dhe pajisjet përkatëse për transportimin e kontenierëve) të përdorur për transportin e të mirave dhe mallrave;

nëse kjo dhënie me qira ose përdorim apo mirëmbajtje, sipas rastit, është shoqëruese e operimit të anijeve ose avionëve nga ndërmarrja në trafikun ndërkombëtar.

3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 zbatohen gjithashtu edhe për fitimet nga pjesëmarrja në një konsorcium, biznes të përbashkët, apo agjenci operative ndërkombëtare.

Neni 9

Ndërmarrjet e asociuara

1. Nëse:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast janë krijuar ose vënë kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare, që dallojnë nga ato që do të ishin krijuar ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë të gjitha fitimet, që do të ishin nxjerrë, nëse nuk do të ishin ato kushte, nga një ndërmarrje, por, që për shkak të atyre kushteve, nuk janë nxjerrë si të tilla, mund të përfshihen në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatohen rregullisht.

2. Nëse një Shtet Kontraktues përfshin në përfitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti – dhe taton sipas tyre- fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është tatuar në shtetin tjetër dhe fitimet e përfshira janë fitime që do të ishin mbledhur nga ndërmarrja e shtetit të parë të përmendur nëse kushtet e vëna ndërmjet të dyja ndërmarrjeve do të ishin ato që do t'u ishin vënë ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm për shumën e tatimit të vënë mbi këto fitime. Në përcaktimin e këtyre rregullimeve, dispozitat e tjera të kësaj Konvente do të konsiderohen në mënyrën e duhur dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, do të konsultojnë njëri-tjetrin.

Neni 10

Dividendët

1. Dividendët që një shoqëri rezidente e një Shteti Kontraktues i paguan një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen në Shtetin Kontraktues ku është rezidente shoqëria që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i caktuar nuk tejkalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve nëse pronari përfitues është një shoqëri (e ndryshme nga një ortakëri) që mban direkt të paktën 25 për qind të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët;

b) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk prek tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet prej të cilave paguhen dividendët.

3. Termi "dividendë" sipas përdorimit në këtë nen do të thotë të ardhura nga aksione të çdo lloji apo të drejta të tjera, që nuk janë pretendime borxhi, të cilat marrin pjesë në fitime, si edhe të ardhura nga të drejta të tjera që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhura nga aksionet sipas ligjeve të shtetit ku është rezidente shoqëria që bën shpërndarjen.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku është rezidente shoqëria që paguan dividendë nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime të pavarura personale nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje dhe duke pasur parasysh këto dividendë paguhen efektivisht në lidhje me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në këtë rast, zbatohen, sipas rastit, dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. Nëse një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, Shteti tjetër nuk mund të vendosë ndonjë taksë mbi dividendët që paguan shoqëria, përveçse për sa kohë që këto dividendë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër, ose për sa kohë, duke pasur parasysh këta dividendë paguhen efektivisht në lidhje me një filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme në shtetin tjetër, as t'ia nënshtrojë fitimin e pashpërndarë të shoqërisë një tatimi mbi fitimin e pashpërndarë të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimi i pashpërndarë përbëhen tërësisht ose pjesërisht nga fitimet ose të ardhurat që nxirren në shtetin tjetër.

Neni 11
Interesi

1. Interesi që del në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këto honorarë mund të tatohet gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku del dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues; tatimi i caktuar nuk kalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të interesit që del në një Shtet Kontraktues dhe që paguhet për çdo hua të çdo lloji të dhënë nga një bankë;

b) 10 për qind të shumës së interesit në të gjitha rastet e tjera.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi që del në një Shtet Kontraktues dhe përfitohet nga qeveria e Shtetit tjetër Kontraktues, duke përfshirë autoritetet lokale të tij, banka qendrore ose një institucion financiar që është në pronësi të plotë të asaj qeverie, apo interesi i paguar në lidhje me një hua të garantuar nga ajo qeveri apo autoritet përjashtohet nga tatimi në shtetin e parë.

4. Termi "interes" i përdorur në këtë nen do të thotë të ardhura nga pretendimi i borxhit të çdo lloji, të siguruara apo jo me hipotekë, dhe me të drejtë apo jo për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe në veçanti të ardhura nga letrat me vlerë të qeverisë dhe të ardhura nga bonot ose detyrimet, përfshirë primet dhe çmime që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, bonove apo detyrimeve. Termi "interes" nuk përfshin të ardhurat që trajtohen si dividendë në bazë të dispozitave të nenit 10. Vënia e gjobave për vonesa në pagesa nuk do të konsiderohen si interes për qëllim të këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafit 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku del interesi, nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime të pavarura personale nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje dhe pretendimi i borxhit në lidhje me të cilën paguhet interesi është i lidhur efektivisht me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në një rast të tillë zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

6. Interesi konsiderohet se ka dalë në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Sidoqoftë, nëse personi që paguan interesin, qoftë ai rezident i një Shteti Kontraktues, apo jo, ka në Shtetin Kontraktues një sipërmarrje të përhershme ose një bazë të qëndrueshme në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi mbi të cilin është paguar interesi dhe ky interes ka dalë nga ky filial i përhershëm ose bazë e qëndrueshme, atëherë ky interes do të konsiderohet se ka dalë në shtetin ku ndodhet filiali i përhershëm ose baza e qëndrueshme.

7. Nëse, për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues, ose ndërmjet të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e interesit, duke pasur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin ai paguhet, tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur të fundit. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të çdo Shteti Kontraktues, duke marrë parasysh si duhet dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 12

Honorarët

1. Honorarët që lindin në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këto honorare mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku lindin dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i honorarëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk kalon 5% të shumës bruto të tarifës për licencë.

3. Termi "honorarë", siç përdoret në këtë nen, do të thotë pagesa të çdo lloji që merren si një shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për vepra letrare, artistike apo shkencore, përfshirë filmat kinematografikë, filmat ose kasetat për transmetim në radio apo televizion, çdo patentë, markë, skicë apo model, plan, formulë sekrete apo proces, apo për përdorimin ose për të drejtën e përdorimit të pajisjeve industriale, tregtare apo shkencore, ose për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i honorarëve, duke qenë rezident në një Shtet Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku lindin honorarët, nëpërmjet një filiali të përhershëm ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilat paguhen honorarët lidhet efektivisht me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në këtë rast zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose të nenit 14.

5. Honorarët konsiderohen që kanë lindur në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Sidoqoftë, kur personi që paguan honorarët, qoftë ai rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në Shtetin Kontraktues një filial të përhershëm ose një bazë të qëndrueshme në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi për të paguar honorarët dhe ky honorar ka lindur nga ky filial i përhershëm ose bazë e qëndrueshme, atëherë këto honorarë do të konsiderohen se kanë lindur në shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose baza e caktuar.

6. Nëse, për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues, ose ndërmjet të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e honorarëve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin janë paguar, tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur të fundit. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të çdo Shteti Kontraktues, duke marrë parasysh si duhet dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 13

Fitimet kapitale

1. Fitimet që një rezident i një Shteti Kontraktues përfton nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Fitimet që një rezident i një Shteti Kontraktues përfton nga tjetërsimi i aksioneve ose nga një interes i krahasueshëm i çdo lloji duke nxjerrë më shumë se 50% të vlerës së tyre direkt apo indirekt nga pasuria e paluajtshme që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që janë pjesë e pronës së biznesit të një

filiali të përhershëm që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose të një prone të luajtshme që i përket një baze të qëndrueshme të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, përfshirë këtu fitimet nga tjetërsimi i këtij filiali të përhershëm (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose i kësaj baze të qëndrueshme, mund të tatohen në shtetin tjetër.

4. Fitimet e përftuara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues që operon anije ose avionë në trafikun ndërkombëtar nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose pronës së luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve ose avionëve, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone tjetër, përveç atyre të përmendura në paragrafët e mësipërm të këtij neni, tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku tjetërsuesi është rezident.

Neni 14

Shërbime personale të pavarura

1. Të ardhurat që përftohen nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me shërbime profesionale ose të tjera të ngjashme të natyrës së pavarur, tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur ai ka një bazë të qëndrueshme në zotërim të tij të përhershëm në shtetin tjetër Kontraktues për të kryer veprimtarinë e tij. Nëse ai ka një bazë të tillë të qëndrueshme, të ardhurat mund të tatohen në shtetin tjetër vetëm në masën që i përkasin kësaj baze të qëndrueshme. Për këtë qëllim, nëse një individ që është rezident i një Shteti Kontraktues qëndron në shtetin tjetër Kontraktues për një periudhë ose periudha që në tërësi i kalojnë 183 ditë të çdo periudhe 12-mujore, që fillon ose përfundon në vitin fiskal në fjalë, ai mendohet të ketë pasur një bazë të qëndrueshme në zotërim të tij të përhershëm në atë shtet tjetër dhe të ardhurat që përftohen nga aktivitetet e përmendura më sipër që kryhen në shtetin tjetër i caktohen asaj baze të qëndrueshme.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht veprimtari të pavarura shkencore, letrare, artistike, edukative apo mësimdhënie, si dhe veprimtari të pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, auditëve dhe llogaritarëve.

Neni 15

Shërbime personale të varura

1. Sipas dispozitave të neneve 16, 18 dhe 19, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfton një rezident i një Shteti Kontraktues për një punësim tatohen vetëm në atë shtet, përveçse kur punësimi është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet kështu, ky shpërblim që rrjedh prej tij mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, shpërblimi që përfton një rezident i një Shteti Kontraktues për punësimin e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues tatohet vetëm në shtetin e përmendur më parë nëse:

a) përfituesi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në tërësi 183 ditë të çdo periudhe 12-mujore që fillon ose mbaron në vitin financiar në fjalë; dhe

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident në shtetin tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk mbulohet nga një filial i përhershëm ose një bazë e qëndrueshme që ka punëdhënësi në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi që del për punësimin e ushtruar në bordin e një anijeje apo avioni që operohet në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues mund të tatohet në atë shtet.

Neni 16
Tarifat e drejtorëve

Tarifat e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose të një organi tjetër të ngjashëm të një shoqërie që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht dispozitave të neneve 14 dhe 15, të ardhurat që përftohen nga një rezident në një Shtet Kontraktues si një argëtues, artist teatri, filmi, radioje apo televizioni, ose muzikant, apo sportist në veprimtarinë e tij personale të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Nëse të ardhurat në lidhje me veprimtaritë personale të ushtruara nga një argëtues apo sportist në cilësinë e tij si i tillë nuk mblidhen për argëtuesin apo sportistin, por për një person tjetër, këto të ardhura mund të tatohen, pavarësisht dispozitave të neneve 7, 14 dhe 15, në Shtetin Kontraktues ku argëtuesi apo sportisti ushtron veprimtarinë e tij.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen për të ardhurat që përftohen nga një argëtues ose sportist prej veprimtarive të ushtruara në një Shtet Kontraktues nëse vizita në atë Shtet mbështetet plotësisht ose pjesërisht nga fondet publike të një ose të dy Shteteve Kontraktues, ose apo autoriteteve vendore të tyre. Në këtë rast, të ardhurat tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku argëtuesi apo sportisti është rezident.

Neni 18
Pensionet

1. Sipas dispozitave të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që i paguhen një rezidenti të një Shteti Kontraktues për punësimin në të kaluarën, tatohen vetëm në atë shtet.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni dhe paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara në bazë të sistemit shtetëror të sigurimeve sociale të një Shteti Kontraktues tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 19
Shërbimet qeveritare

1. a) Pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, përveç pensionit, që një Shtet Kontraktues, apo autoritet vendor i paguan një individi në lidhje me shërbimet që i janë bërë atij shteti apo autoriteti, tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto paga dhe shpërblime të ngjashme tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet janë bërë në atë shtet dhe individi është rezident i atij shteti:

i) ku është shtetas, ose

ii) kur nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllimin e kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga, ose prej fondeve të krijuara nga një shtet kontraktues apo autoritet vendor për një individ në lidhje me shërbimet që i janë bërë atij shteti apo atij autoriteti, do të tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, ky pension tatohet vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individi është rezident ose shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 zbatohen për pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme dhe për pensionet, në lidhje me shërbimet që janë kryer për një biznes të kryer nga një

Shtet Kontraktues ose autoritet vendor i tij.

Neni 20
Studentët dhe stazhierët

1. Pagesat që merr një student, stazhier ose nxënës që është ose ishte menjëherë para vizitës së një Shteti Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e parë vetëm për qëllimet e arsimimit të tij ose të shërbimeve të trajnimit për qëllimin e jetesës, arsimit ose trajnimit nuk tatohen në atë shtet, me kusht që këto pagesa të vijnë nga burimet jashtë atij shteti.

2. Në lidhje me pagesat që nuk mbulohen nga paragrafi 1 i këtij neni dhe shpërblimin për shërbimet e varura personale të dhëna gjatë këtij arsimi apo trajnimi, një student, stazhier ose nxënës ka të drejtën e të njëjtave përjashtime, përfitime ose zbritje në lidhje me taksat për të ardhurat që ofrohen për rezidentët e Shtetit Kontraktues ku ai është me vizitë.

Neni 21
Veprimtaria jashtë territorit

1. Dispozitat e këtij neni zbatohen pavarësisht dispozitave të neneve 5 deri 20 të kësaj Konvente.

2. Për qëllimet e këtij neni, termi "aktivitete jashtë territorit" do të thotë aktivitete që kryhen jashtë territorit të një Shteti Kontraktues në lidhje me kërkimin ose shfrytëzimin e shtratit të detit dhe nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore që ndodhen në atë shtet.

3. Një person që është rezident i një Shteti Kontraktues dhe kryhen aktivitete jashtë territorit në Shtetin tjetër Kontraktues, në pajtim me paragrafin 4, mendohet të kryejë biznes në atë shtet tjetër me anë të një filiali të përhershëm ose baze të qëndrueshme që ndodhet atje.

4. Dispozitat e paragrafit 3 nuk zbatohen nëse aktivitetet jashtë territorit kryhen për një periudhë ose periudha që në tërësi nuk i kalojnë 30 ditë në çdo periudhë 12-mujore. Për qëllimet e këtij paragrafi:

a) aktivitetet jashtë territorit të kryera nga një person që është i asociuar me një person tjetër mendohen të jenë kryer nga personi tjetër nëse aktivitetet në fjalë janë thelbësisht të njëjta si ato të kryera nga personi i parë, përveç deri në masën që ato aktivitete kryhen në të njëjtën kohë si aktivitetet e veta;

b) një person mendohet të jetë i asociuar me një person tjetër nëse njëri kontrollohet drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt nga tjetri, ose të dy kontrollohen drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt nga një ose disa persona të tretë.

5. Pagat ose shpërblimet e tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim që ka të bëjë me një aktivitet jashtë territorit në Shtetin tjetër Kontraktues, në masën që detyrat kryhen jashtë territorit në shtetin tjetër, tatohen nga ai shtet. Megjithatë, një shpërblim i tillë tatohet vetëm në shtetin e parë, nëse punësimi kryhet për një punëdhënës që nuk është rezident i shtetit tjetër dhe për një periudhë ose periudha që në tërësi nuk i kalojnë 30 ditë në një periudhë 12-mujore.

6. Fitimet që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi:

a) i të drejtave të kërkimit ose shfrytëzimit; ose

b) i pasurisë që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues që përdoret në lidhje me aktivitetet jashtë territorit të kryera në shtetin tjetër; ose

c) i aksioneve që e marrin vlerën e tyre ose pjesën më të madhe të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt nga këto të drejta ose kjo pasuri ose nga ato të drejta dhe pasuri të marra së bashku,

mund të tatohen në shtetin tjetër.

Në këtë paragraf termi "kërkimi ose të drejtat e kërkimit" do të thotë të drejtat për sendet pasurore që prodhohen nga aktivitetet jashtë territorit që kryhen në Shtetin tjetër Kontraktues, ose interesat apo përfitimet e këtyre sendeve pasurore.

Neni 22
Të ardhura të tjera

1. Zëra të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kurdo që lindin, që nuk janë trajtuar në nenet e mësipërme të kësaj Konvente, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për të ardhura, përveç të ardhurave nga prona e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje, dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilën paguhen të ardhurat lidhet efektivisht me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7 ose të nenit 14 sipas rastit.

Neni 23
Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e paluajtshme përmendur në nenin 6, në pronësi të një rezidenti të një Shteti Kontraktues dhe i vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri e luajtshme që bën pjesë në pronën e biznesit të një filiali të përhershëm që një ndërmarrje e Shtetit Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga prona e luajtshme që i përket një baze të qëndrueshme në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer shërbime personale të pavarura, mund të tatohet në Shtetin tjetër Kontraktues.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet ose avionët që operohen në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues dhe nga prona e luajtshme që i përket funksionimit të këtyre anijeve apo avionëve tatohet vetëm në atë shtet.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontaktues tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 24
Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Në Shqipëri tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

a) Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura ose ka në pronësi kapital i cili, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohet në Letoni, Shqipëria do të lejojë:

i) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Letoni;

ii) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Letoni.

Megjithatë, kjo zbritje, në secilin rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin, të llogaritur përpara se të bëhet zbritja, e cila sipas rastit bëhet për të ardhurat ose kapitalin që mund të tatohet në Letoni.

b) Nëse në përputhje me çdo dispozitë të Konventës, të ardhurat e përftuara ose kapitali në pronës të një rezidenti të Shqipërisë përjashtohet nga tatimi në Shqipëri, pavarësisht nga kjo, Shqipëria, në llogaritjen e shumës së tatimeve mbi të ardhurat apo kapitalin që mbetet për këtë rezident, merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Në Letoni tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

a) Nëse një rezident i Letonisë përfton të ardhura ose ka në pronësi kapital i cili, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohet në Shqipëri, nëse në bazë të ligjit të vet nuk i jepet një trajtim më i favorshëm, Letonia do të lejojë:

i) si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Shqipëri;

ii) si zbritje nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Shqipëri.

Megjithatë, kjo zbritje, në secilin rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin në Letoni, të llogaritur përpara se të bëhet zbritja, e cila sipas rastit bëhet për të ardhurat ose kapitalin që mund të tatohet në Shqipëri.

b) Për qëllimet e nënparagrafit a), nëse një shoqëri që është rezidente e Letonisë merr një dividend nga një shoqëri që është rezidente e Shqipërisë ku ajo ka në pronësi të paktën 10 për qind të aksioneve të saj që kanë të drejta të plota vote, tatimi i paguar në Shqipëri përfshin jo vetëm tatimin e paguar për dividendin, por gjithashtu edhe pjesën e përshtatshme të tatimit të paguar për fitimet përkatëse të shoqërisë nga të cilat janë paguar dividendët.

3. Nëse një pajtim me ligjin e Shtetit Kontraktues lejohet një përjashtim ose zvogëlim i tatimeve të rregulluara nga kjo Konventë për qëllimin e inkurajimit të zhvillimit ekonomik në atë Shtet Kontraktues, tatimi që do të ishte paguar nëse nuk do të ishte ky përjashtimi ose zvogëlim mendohet të jetë paguar për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni. Kjo dispozitë zbatohet vetëm për dhjetë vitet e para gjatë të cilëve është në fuqi kjo Konventë. Kjo periudhë mund të zgjatet me marrëveshje reciproke ndërmjet autoriteteve kompetente. Shtetet Kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin për një marrëveshje të tillë nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 25
Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk i nënshtrohen në Shtetin tjetër Kontraktues asnjë tatimi apo kërkese që lidhet me të, që është e ndryshme ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilat u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen shtetasit e shtetit tjetër në të njëjtat rrethana, sidomos në lidhje me rezidencën. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, kjo dispozitë zbatohet gjithashtu për personat që nuk janë rezidentë të njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese.

2. Personat pa shtetësi, që janë rezidentë të një Shteti Kontraktues, nuk do t'i nënshtrohen në asnjë Shtet Kontraktues tatimit apo kërkesës në lidhje me të, që është e ndryshme ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilave u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen shtetasit e shtetit tjetër në të njëjtat rrethana, sidomos në lidhje me rezidencën.

3. Tatimi mbi një filial të përhershëm që ka një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të mblidhet në shtetin tjetër me më pak favorizim sesa tatimi që mblidhet nga ndërmarrjet e shtetit tjetër që kryejnë të njëjtat veprimtari. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyrim për Shtetin Kontraktues që t'u japë rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues ndihmë personale, lehtësime dhe reduktime për qëllime tatimore në emër të gjendjes civile apo përgjegjësive familjare që u jep rezidentëve të tij.

4. Përveçse kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 neni 9, paragrafit 7 neni 11, apo paragrafit 6 neni 12, interesat, tarifat për licencë, dhe disbursime të tjera që i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues nga një ndërmarrje e Shtetit Kontraktues, me qëllim që të përcaktohen fitimet e tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të reduktohen me të njëjtat kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të parë të përmendur. Po kështu, çdo detyrim i një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues për një rezident të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim që të përcaktohet kapitali i tatueshëm i kësaj ndërmarrjeje do të reduktohet sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin kontraktuar një rezidenti të shtetit të parë të përmendur.

5. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose kontrollohet tërësisht apo pjesërisht, direkt apo indirekt nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk i nënshtrohen në shtetin e parë të përmendur tatimit apo kërkesës tjetër të lidhur me të që është e ndryshme ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilave

u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen ndërmarrje të ngjashme të shtetit të parë të përmendur.

6. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht dispozitave të nenit 2, zbatohen për tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi.

Neni 26

Procedura e marrëveshjes reciproke

1. Nëse një person konsideron që veprimet e njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për atë në tatim që nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, ai, pavarësisht nga mjetet e parashikuara në të drejtën e brendshme të atyre shteteve, mund të paraqesë çështjen e tij tek autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues ku është rezident, ose, nëse çështja e tij është sipas paragrafit 1 të nenit 25, te Shteti Kontraktues ku ai është shtetas. Çështja duhet të paraqitet brenda tri viteve nga njoftimi i parë i veprimit që ka rezultuar në vënien e tatimit që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent përpiqet, nëse kundërshtimi duket i justifikuar, dhe nëse nuk është e mundur të arrihet një zgjidhje e kënaqshme, të zgjidhë çështjen me marrëveshje reciproke me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim për të shmangur tatimin që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e përfunduar do të zbatohet pavarësisht kufizimeve kohore në të drejtën e brendshme të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen të zgjidhin me marrëveshje reciproke vështirësitë apo dyshimet që lindin për interpretimin ose shpjegimin e Konventës. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet që nuk parashikohen në Konventë.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund t'i komunikojnë njëri-tjetrit direkt qëllimet për arritjen e një marrëveshjeje sipas kuptimit të paragrafëve të mësipërm, edhe nëpërmjet një komisioni të përbashkët që përbëhet prej tyre përfaqësuesve të tyre.

Neni 27

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacion të nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente apo ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi që vihen në emër të Shteteve Kontraktuese, ose të autoriteteve vendore, përsa kohë që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1 dhe 2. Çdo informacion që merret nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet i fshehtë në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe do t'i jepet vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin apo ndjekjen, apo zgjidhjen e ankesave në lidhje me tatimet e përmendura në fjalinë e parë. Këto persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund të japin këtë informacion në procedime gjyqësore publike ose në vendime gjyqësore.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në mënyrë që t'i imponojnë një Shteti Kontraktues detyrimin:

a) për të marrë masa administrative në përputhje me ligjet dhe praktikat administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) për të siguruar informacion që nuk mund të merret sipas ligjeve ose në rrugën normale të administratës të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) për të siguruar informacion që do të zbulonte ndonjë sekret tregtar, biznesi, industrial, apo profesional apo proces tregtie, ose informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikat publike (rend publik).

Neni 28

Anëtarë të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do të ndikojë në privilegjet financiare të anëtarëve të misioneve diplomatike apo posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 29

Hyrja në fuqi

1. Qeveritë e Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën që janë plotësuar procedurat e tyre ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Konvente.

2. Konventa hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit të përmendur në paragrafin 1 dhe të gjitha dispozitat e saj kanë efekt në të dy Shtetet Kontraktuese:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim, për të ardhurat që përftohen në 1 janar ose pas 1 janarit të vitit kalendarik të vitit pasardhës kur ka hyrë në fuqi Konventa;

b) në lidhje me tatime të tjera mbi të ardhurat, kapitalin, për tatimet e vendosura për çdo vit tatimor duke filluar nga 1 janari i vitit kalendarik pas vitit të hyrjes në fuqi të Konventës.

Neni 30

Prishja

Kjo Konventë mbetet në fuqi derisa të prishet nga një Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të prishë Konventën, nëpërmjet rrugëve diplomatike, duke bërë një njoftim me shkrim për përfundimin të paktën gjashtë muaj përpara fundit të çdo viti kalendarik, pas periudhës pesëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të Konventës. Në këtë rast, Konventa nuk do të ketë më fuqi në të dy Shtetet Kontraktuese:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim, për të ardhurat që përftohen më 1 janar ose pas 1 janarit të vitit të ardhshëm kalendarik pas vitit kur është dhënë njoftimi;

b) në lidhje me tatime të tjera mbi të ardhurat, kapitalin, për tatimet e vendosura për çdo vit tatimor duke filluar nga 1 janari dhe pas tij të vitit pasardhës kalendarik pas vitit kur është dhënë njoftimi.

Si dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, me autoritet të plotë për këtë, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në dy kopje, në Tiranë, më 21 dita e shkurtit 2008, në shqip, letonisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njësoj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.